



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 19 Prill 2023

Nr: 387

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE NR. 151, 152, 153, 165, 166, 177, 216, 217, 224, 231, 232, 234, 235, 236, 245, 257, 263, 268, 271, 272, 277, 278, 279, TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ PERSONAVA PËRGJEGJËS, PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 19 Prill 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)
Sinjalizues

SUBJEKT: Zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lushnje;
Zj. Arisa Toska, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Berat;
Z. Nertil Nebiaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastër;
Z. Dritan Babasuli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Pogradec;
Z. Elvis Gjika person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kamëz;
Z. Taulant Fejzulla, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Vorë;
Z. Florenc Doka person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Cërrik;

Data: 19 Prill 2023

Nr: 387
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike”

Z. Genci Floqi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Maliq;
Zj. Urjeta Kurti, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Dibër;
Z. Oltjon Çoba, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë, Bashkia Fushë Arrëz.
Z. Astrit Seferkollli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll;
Z. Vangjel Xhaferi person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Finiq;
Zj. Marsida Fani person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kuçovë;
Zj. Rajmonda Zisi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Himarë;
Zj. Klevisa Rrudha, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Divjakë;
Zj. Emirjona Pergjegjaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Pukë;
Zj. Vikrita Cuto, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Ministrisë të Infstrukturës dhe Energjisë.

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për organizimin e 23 (njëzet e tre) veprimtarive publike, nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) institucione publike, për të cilat pretendohet se nuk janë raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim.

Indiciet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t'u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime nëpërmjet provave link dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja "ç" të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike të paraportuar në ndërfaqe.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

1- Bashkia Lushnje nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 217 ID**, për të cilat pretendohet si vijon:

- *Denoncimi nr. 217 ID, "Drejtorja e Shërbimit Social pranë bashkisë Lushnjë në bashkëpunim me NJVKSH organizuan takime sensibilizuese dhe informuese me banorë të komunitetit Egjiptian dhe Rom. Në fokus të takimeve përveç njohjes së vazhdueshme me shqetësimet e tyre më të mëdha ishin edhe angazhimi për të luftuar diskriminimin e anëtarëve të këtyre komuniteteve dhe gjithëpërfshirjen e tyre, sidomos në projekte dhe iniciativa që i prekin në mënyrë direkte. Bashkia Lushnje ka aktualisht një qendër komunitare financiar nga #PNUD ku trajtohen 85 familje të këtyre komuniteteve!
Në Savër gjithashtu në funksion të këtij komuniteti, por edhe të gjithë zonës do të ndërtohet këtë vit një qendër shëndetësore! "*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=608528021317013&set=pcb.608528087983673>

Më datë 28.3.2023, bashkisë Lushnje, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, ku jemi informuar se: "Në vijim të e-mail-it tuaj lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve ju sqarojmë se ky aktivitet është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, nga institucioni ynë, link-u:

<https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/03/15/dita-nderkombetare-per-eeliminimin-dhe-diskriminimi-racial/> . Ju informojmë se data është 21.03.2023, në orën 10:00, e organizuar nga bashkia Lushnjë, tematika e aktivitetit është "Takime për Ditën Ndërkombëtare për Eleminimin dhe Diskriminimin Racial", me pjesëmarrjen e medias sociale.

2- **Bashkia Berat** nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2 (dy) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 231, 232 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 231 ID**, "Takim me drejtuesit e Insitucioneve Arsimore, diskutuam rreth sfidave dhe mbi të gjitha punën e përbashkët për përmirësimin e vazhdueshëm të institucioneve arsimore. Arsimtarët janë jetik për përgatitjen e brezave dhe formimin e qytetarëve të përgjegjshëm. Të përkushtuar dhe të palodhur për arsimimin dhe edukimin sa më të mirë e fëmijëve tanë."

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=754336869581828&set=pcb.754337072915141>

- Denoncimi **nr. 232 ID**, "Një takim plot energji me zonjat e mrekullueshme të Kalasë, diskutuam për projektet e reja dhe fantastike që presin lagjen Kala së shpejti "

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=754149192933929&set=pcb.754149776267204>

Më datë 3.4.2023, bashkisë Berat i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe me datë 4.4.2023, jemi informuar se në lidhje me denoncimin nr. 231 ID "Aktiviteti është raportuar më datë 24.03.2023 në ndërfaqe sipas link <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/03/24/inspektim-dhe-takim-me-banore-te-nj-adm-roshnik/>", ndërsa në lidhje me denoncimin nr. 232 ID ,sqaron se "Aktiviteti i postuar "Nje takim plot energji me zonjat e mrekullueshme të Kalasë diskutuam për projektet e reja dhe fantastike që presin lagjen Kala së shpejti" theksojmë se **ishte nje takim i paplanifikuar dhe ndodhi rastesisht** pasi një grup zonjash të lagjes Kala, të mbledhura për shkak të pranisë se shumë artistëve të njohur të qytetit në lagjen e tyre, kërkuan të takoheshin edhe me kryetarin e bashkisë, i cili i ndodhur në këtë situatë u ul dhe bisedoi me një grup prej tyre për hallet problemet e tyre etj, për një minutazh të shkurtër para takimit që kishte me artiste të qytetit. Shpjegojmë se prania e artistëve në lagjen Kala ishte për shkak të

organizimit të takimit të raportuar më datë 24.03.2023, në ndërfaqe sipas linkut: <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/03/24/takim-me-artiste/>.

3- Bashkia Gjirokastrë nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 245 ID**, për të cilën pretendohet në raportin e monitorimit me kod unik 43723392 si vijon:

- Denoncimi **nr. 245 ID**, " Në datën 31.03.2023 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zj. Ogerta Manastirliu, me Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit zj. Mirela Kumbaro, dhe kryetarin e bashkisë Gjirokastrë z. Flamur Golemi, zhvilluan një takim në spitalin e Gjirokastrës me mjekë të këtij spitali për të parë nga afër përfundimin e investimit të ri, që po bëhet për ndërtimin e poliklinikës së rehabilituar. Gjithashtu zj. Manastirliu foli edhe për rritjen e pagës së mjekëve, që fillonte këtë muaj."

Më datë 3.4.2023 bashkisë Gjirokastrë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 5.4.2023, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bën me dije se "Organizues i veprimtarisë me karakter publik ka qenë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Fondet e përdorura në këtë investim janë fonde të disponuara prej kësaj ministrie dhe të vëna në dispozicion të realizimit të projektit me përfitues spitalin "Omer Nishani" Gjirokastrë. Informacioni më i detajuar duhet ti kërkohej Ministrisë përkatëse pasi Z. Flamur Golemi/ kryetar i bashkisë Gjirokastrë, ka qenë thjeshtë pjesëmarrës në këtë aktivitet të ditës së shtunë datë 1.4.2023 dhe është vënë në dijeni ditën e realizimit të këtij aktiviteti. Publikimi i këtij aktiviteti është bërë nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Linku si me poshte vijon:

<https://shendetesia.gov.al/perfundon-investimi-ne-polikliniken-e-gjirokastrës-manastirliu-kumbaro-do-te-rehabilitohet-edhe-spitali-rajonal/>

Në vijim, po ashtu, më datë 6.4.2023 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit bën me dije se "...takimi në spitalin e Gjirokastrës datë 31.03.2023, është një takim i organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndërkohë, znj. Kumbaro ka qenë e ftuar për të marrë pjesë në këtë takim. Menjëherë pas ftesës, kemi kërkuar konfirmim nga institucioni organizues, nëse ky aktivitet është publikuar apo jo dhe nëse është cituar edhe emri i zj. Kumbaro si pjesëmarrëse në këtë takim. Nga ana e institucionit është konfirmuar publikimi i aktivitetit dhe për këtë arsye, ky aktivitet nuk është publikuar nga ana jonë. Gjithashtu, bëjmë me dije se kemi verifikuar edhe që ky aktivitet nuk përfshihej tek aktivitetet e ndaluara për tu zhvilluar. Sa më sipër, në dokumentin bashkëlidhur do të gjeni aktivitetin i cili rezultoi i publikuar."

4- Bashkia Pogradec nuk ka raportuar 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 279 ID**, për të cilat pretendohet si vijon:

Data: 19 Prill.2023

Nr: 387
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike"

- Denoncimi nr. 279 ID “Zhvillova një takim me banorë të lagjes "Topleci" dhe Rr. "Naim Frashëri" për të diskutuar me ta mbi vizionin tonë për zhvillimin e këtyre dy zonave historike të qytetit. Tashmë ne kemi në dorë projektin dhe mënyrën se si do t'i transformojmë të dyja lagjet. gjermane dhe sapo të përfundojnë të gjitha procedurat ligjore përkatëse, për pak muaj Projekti ka gjetur financimin nga KFË nisim nga puna. Do t'i japim "Toplecit" dhe "Naim Frashërit" pamjen e merituar në infrastrukturë, fasada, ndriçim dhe shumë elementë të tjerë urbanë. Së shpejti në dy lagjet jonetëm do të investohet, por do të jenë poli i ri turistik për Pogradecin. #vazhdojmëbashkë #pogradeciqeduam”

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=610098034496899&set=pcb.610098481163521>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 11.4.2023, bashkisë Pogradec, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe më datë 12.4.2023 jemi informuar se: “Aktiviteti është raportuar në KQZ në datën 23 Mars 2023 për këtë po ju bashkëngjitem edhe provën e postimit që e gjeni tek aktivitetet tona të raportuara në KQZ...”.

- 5- **Bashkia Kamëz** nuk ka raportuar 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me nr. 257 ID, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 257 ID, “Zall-Mner i Ri Gjatë inspektimit të punimeve për rikonstruksionin total të shkollës 9-vjeçare “Fatos Lami” e cila do të ofrojë standarde europiane për 691 nxënës. Krenarë për revolucionin arsimor të munguar prej 30 vitesh.”

Prova link:

<https://www.facebook.com/100044332874482/videos/1901430463547473/>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 11.4.2023, bashkisë Kamëz, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe jemi informuar se “...Nga ana e Bashkisë Kamëz është realizuar detyrimi ligjor për raportimin e veprimtarisë në fjalë me karakter publik. Paqartësia nga denoncuesit mbi këtë veprimtari shpjegohet me faktin se, është ndryshuar emri i Shkollës 9-vjeçare “Azem Hajdari” Zall-Mner në Shkollën 9-vjeçare “Fatos Lami” Zall-Mner. Sa më sipër: Nga ana e Bashkisë Kamëz është raportuar në ndërfaqen e raportimeve: Inspektim punimesh ne Shkollën 9-vjeçare “Azem Hajdari” Zall-Mner, Bashkia Kamëz...”.

Përsa më sipër, nga verifikimi i të dhënave në ndërfaqen e raportimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se organizatorët e aktiviteteve për denoncimet **nr. 217, 231, 232, 245, 279 dhe 257 ID për bashkitë Lushnje, Berat ,Gjirokastrë dhe Pogradec dhe Kamëz**, kanë përmbushur detyrimin për raportim të parashikuar nga neni 92, të Kodit Zgjedhor. Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti për këto denoncime nuk përmban elementë për konstatimin e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

6- Bashkia Vorë nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 3 (tre) veprimtari publike, të regjistruara me **nr. 234, 235, 236 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 234 ID**, *“VORË- TAKIM ME BANORË NË GJOKAJ- Në çdo ditë do jemi pranë qytetarëve dhe biseda jonë me ta mbështetet në kërkesat dhe nevojat e tyre. Vora arsyen kryesore për tu transformuar ka mbështetjen në komunitet.*

#PS #BashkiaVorë #PartiaSocialiste”.

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=212867771332891&set=pcb.212867894666212>

- Denoncimi **nr. 235 ID**, *“VORË- TAKIM ME BANORË TË MARQINETIT- Çdo ditë ne jemi në komunitet duke dëgjuar dhe paraqitur planin tonë për transformimin e Vorës. 14 Maj do të jetë vazhdimi i punë në qytet dhe krijimi hapësirave të reja.*

#PS #BashkiaVorë #SkaKohePerPushim” Një takim plot energji me zonjat e mrekullueshme të Kalasë. Diskutuam për projektet e reja dhe fantastike që presin lagjen Kala së shpejti”

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=213432874609714&set=pcb.213433144609687>

- Denoncimi **nr. 236 ID**, *“VORË- TAKIM NË ME BANORËT NË MUÇAJ- Viojmë takimet dhe organizimin në territor. Rezultati i Partisë Socialiste dhe i Bashkisë Vorë do të jetë i thellë fal punës së përditshme me qytetarët. #PS #Vore #SkaKohePerPushin #VoraPunON”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=214185871201081&set=pcb.214186301201038>

Më datë 3.4.2023, bashkisë Vorë, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe jemi informuar më datë 4.4.2023 se *“...këto aktivitete janë organizuar në kuadër të veprimtarive politike - zgjedhore me pjesëmarrjen e elektoratit zgjedhor dhe përfaqësuesve të partisë politike. Këto takime janë zhvilluar të gjitha pas orarit zyrtar të punës dhe nuk janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit dhe as në rrjetet zyrtare sociale të institucionit. Për sa më sipër, theksojmë se këto aktivitete nuk janë organizuar nga institucioni i bashkisë Vorë në kuadër të veprimtarisë së tij publike”.*

7- **Bashkia Cërrik** nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 3 (tre) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 151, 152, 153 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 151 ID** *"NJA GOSTIMË Lagja e #Çahireve dhe fshatrat #Çartallos e #Banjë ishin ndalesat tona të rradhës të realizuara me banorët për të ndarë bashkë problematikat dhe shqetësimet e tyre. #BashkiaCërrik #PartiaSocialiste #SkaKohëPërPushim"*
<https://www.facebook.com/photo/?fbid=635656135237428&set=pcb.635656298570745>
- Denoncimi **nr. 152 ID**, *"NJA GOSTIMË Bashkëbisedimet tona i vazhduam në fshatin #Malasej dhe me banorët e lagjes së #Kamamsve, ku diskutuam për çfarë kemi bërë e çfarë do të duhet të bëjmë akoma më shumë. #BashkiaCërrik #PartiaSocialiste #SkaKohëPërPushim "*
<https://www.facebook.com/photo/?fbid=639146311555077&set=pcb.639146548221720>
- Denoncimi **nr. 153 ID**, *"NJA SHALËS Bashkëbisedimet tona me banorët për të dëgjuar shqetësimet dhe problematikat e tyre, i vazhduam në njësinë Shalës me banorët e lagjes së #Liçajve #Çapallarëve dhe #Trokallinjve #BashkiaCërrik #PartiaSocialiste #SkaKohëPërPushim"*
<https://www.facebook.com/photo/?fbid=639797384823303&set=pcb.639797454823296>

Më datë 13.3.2023, bashkisë Cërrik i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike. Bashkia Cërrik nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për bashkëpunim në kuadër të hetimit administrativ.

Në vijim të hetimit administrativ, bashkia Cërrik, u njoftua për të marrë pjesë në seancën publike të datës 5.4.2023, ora 12:00, por nuk pati përfaqësues gjatë seancës publike.

8- **Bashkia Maliq** nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 216 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 216 ID**, *"Në Orman këtë mbasditë për një kafe dhe për të biseduar për skemën e suvencioneve në bujqësi e blektori që fillon nga nesër edhe në sportelet e Bashkisë Maliq dhe Njësi Administrative. Sigurimi për herë të parë i ujit 24-orë një arritje tjetër për të cilën morëm vlerësim maksimal nga banorët.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=5910868582329584&set=pcb.5910884612327981>

Më datë 28.3.2023 bashkisë Maliq i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 29.3.2023 bën me dije se përsa i përket aktivitetit objekt i denoncimit nr. **216 ID** *"Konkretisht takimi i kryer nga titullari ka qenë i rastësishëm, në një kafene të fshatit Orman, i thirrur nga vetë banorët e fshatit të cilët kishin marrë indicie nga rrjetet sociale në lidhje me Skemën Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi, që do të*

zhvillohet nga Ministria e Bujqësisë dhe kërkuan një informacion se si do të zhvillohej skema e subvencioneve në bujqësi e blegtori. Takimi është zhvilluar ditën e diel pasdite, më datë 19.3.2023, pikërisht një ditë përpara publikimit të skemës së mbështetjes në datë 20.3.2023. Për pasojë ky takim jo publik është zhvilluar rastësisht nga kërkesa e banorëve duke marrë indicie në rrjetet sociale se nga një institucion tjetër, siç është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rura, do të zhvillohet një skeme subvencionesh në bujqësi dhe blegtori... Nisur nga këto argumente pretendojmë se nuk jemi përpara një veprimtarie të ndaluar dhe nuk ka qenë qëllimi i institucionit që të shmangej nga përgjegjësia ligjore e raportimit të një veprimtarie. Theksojmë se takimi ka qenë i rastësishëm dhe me karakter informues në lidhje skemen kombëtare të subvencionimit. Bashkia Maliq në këtë rast nuk ka asnjë fond për zhvillimin e kësaj skeme. Fondi administrohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural...”.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas shqyrtimit të materialeve u vlerësua se natyra e aktiviteteve të kryera nga kryetarët e bashkisë Vorë dhe Cërrik, janë të karakterit politik dhe nuk janë veprimtari publike të institucionit të bashkisë. Aktivitetet e zhvilluara dhe të regjistruara me nr. **234, 235, 236, 151, 152, 153, 216 ID** janë zhvilluar në kuadër të veprimtarive politike me anëtarë dhe mbështetës të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Kryetari i bashkisë, si funksionar i partisë ku aderon, mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete dhe të shprehë mendimet e veta. Këto veprimtari nuk kanë detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve pasi nuk janë zhvilluar në cilësinë si kryetarë bashkie. Përsa më sipër, rezultoi se veprimtaritë objekt denoncimi të regjistruara nr. **234, 235, 236 ID për bashkinë Vorë, me nr. 151, 152, 153 ID për bashkinë Cërrik dhe me nr. 216 për bashkinë Maliq** nuk përmbajnë fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenet 91, dhe 92 të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

9- Bashkia Dibër/ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 224 ID** për të cilën pretendohet nga sinjalizuesi si vijon:

- Denoncimi **nr. 224 ID**, “*Bashkia Dibër së bashku me zv/Kryeministren zj. Belinda Balluku, njëkohësisht edhe drejtuese politike e Qarkut Dibër janë përfshirë në një javë aktivitete, si e quan vetë zj. Balluku në publikimin e saj në Facebook. Ndër këto aktivitete në takimin me mësuesit në Peshkopi kanë shpërndarë njëkohësisht certifikata mirënjohje, për mësuesit. Mendoj se këto veprimtari publike nuk janë raportuar në KQZ, në përputhje me nenin 92, të Kodit Zgjedhor, pasi nuk ka arsye që KQZ të miratojë dhënien e certifikatave për kontribut në arsim nga dy zyrtarë të lartë, që nuk kanë lidhje me fushën e arsimit (pra nuk është as Ministria e Arsimit as drejtuesi i Zyrës Vendore Arsimore). Jepen certifikata për mësuesit nga drejtuesi politik në qark si dhe kandidati për zgjedhjet e datës 14 Maj”.*

Më datë 28.03.2023, bashkisë Dibër dhe Ministrinë të Infrastrukturës dhe Energjisë zj. Belinda Balluku, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, ku janë dërguar të dhënat e aktivitetit të organizuar.

Më datë 31.3.2023, Këshilltari për Medianë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë bën më dije se *“Aktiviteti i organizuar nga bashkia Dibër, të cilit i referohet kërkesa juaj, lidhet me 7 Marsin, ditën e mësuesit dhe kishte në fokus vlerësimin e disa mësuesve me karrierë të gjatë në institucionet arsimore të kësaj bashkie, një pjesë e mirë e të cilëve tashmë ka dalë në pension. Certifikatat e mirënjohjes të akorduara nga bashkia lidheshin me rolin e tyre si kontributorë të veçantë në komunitetin e Dibrës dhe jo në funksion të aftësive të tyre mësimdhënëse, pjesë e kompetencës së Ministrisë së Arsimit. Për shkak të dinamikës ditore të punës ky aktivitet është pasqyruar në rrjetet sociale të znj. Balluku, në datën 12 mars, disa ditë pas zhvillimit të tij. Shprehja që shoqëron postimin në rrjetet sociale lidhet me aktivitete e zhvilluara në përgjithësi në këtë qark në kuadër të ditës së mësuesit dhe ditës së gruas dhe jo me aktivitete të znj. Balluku.”*

Gjithashtu me e-mail-in e datës 3.4.2023, bashkia Dibër po ashtu pohon saktësisht të njëjtat rrethana dhe fakte lidhur me aktivitetin mbi ndarjen e certifikatave të mirënjohjes për mësuesit.

10- Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 166 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 166 ID**, i iniciuar nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) *“Me rastin e 8 marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, kryetari i bashkisë Fran Tuci, organizoi sot në ambientet e Bar- Restorant "Internacional" (ish-turizmi), një aktivitet festiv me gra dhe vajza të të gjithë territorit të bashkisë, punonjëse dhe drejtuese të institucioneve të ndryshme, përfaqësuese dhe aktiviste të OJF-ve, etj. Në fjalën përshëndetëse, kryetari Tuci, teksa i uroi pjesëmarrëset për 8 marsin, shprehu angazhimin e tij institucional për më shumë hapësira në afirmimin e femrës si potencial drejtues dhe vendimmarrës, si një element thelbësor për emancipimin e familjes, shoqërisë dhe kombit tonë. Gjithashtu, kryebashkiaku Tuci, nënvizoi se sot është dita e nderimit dhe e mirënjohjes më të thellë ndaj nënave, grave, vajzave, motrave tona, që me sakrificat, përkushtimin, aftësitë dhe dashurinë e tyre janë themeli i suksesit të një shoqërie, ndaj dhe bashkërisht mundemi të adresojmë dhe t'u japim zgjidhje shumë problematikave që lidhen me qasjen ndaj individit dhe familjes. Veprimtaria më pas vijoi me atmosferën e hareshme të tingujve muzikës dhe koktejlit. Bashkia Fushë-Arrëz, faqja zyrtare”.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=115135684852036&set=pcb.115137844851820>

Data: 19 Prill.2023 Nr: 387
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike”

Më datë 13.3.2023 bashkisë Fushë-Arrëz i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk i është përgjigjur kërkesës sonë.

11- Bashkia Devoll nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 165 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 165 ID**, i iniciuar nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) *“Në kuadër të ditës Ndërkombëtare të Gruas, bashkia Devoll në bashkëpunim me UNDP dhe Qendra Treja, organizuan në ambientet e Qendrës Shumëfunktionale Komunitare një aktivitet festiv për gratë dhe vajzat e komunitetit rom dhe jo vetëm. Duke përcjellë urime të përzemërta dhe momente festive, theksuam dhe faktin se simbolika e kësaj dite të shënuar duhet të shërbejë dhe për të reflektuar, për t'u bashkuar më shumë se kurrë për të mos lejuar asnjë lloj diskriminimi, dhune apo trajtimi të pabarabartë ndaj çdo vajze dhe gruaje. #8mars #DitaGruas #StopDhunës #UNDP #QendraTreja #BashkiaDevoll”.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=577297144428104&set=pcb.577297421094743>

Më datë 13.3.2023 bashkisë Devoll i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk i është përgjigjur kërkesës sonë.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ për denoncimet me **nr. 224 ID për bashkinë Dibër dhe Minsitrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, nr. 166 ID për bashkinë Fushë-Arrëz dhe 165 për bashkinë Devoll** rezultoi për shkak të tematikës dhe natyrës, aktivitetet e mësipërme nuk futen në kategorinë e veprimtarive të cilat kanë detyrimin për raportim në kuptim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ sepse objekti rast denoncimi me nr. 224 ID, 166 ID dhe 165 ID nuk përmban rrethana, që mund të përfshihen në parashikimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

12- Bashkia Finiq nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 177 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 177 ID**, *“Në Vrion, sot vijoi punën drejtorja përgjegjëse e infrastrukturës së bashkisë së Finiqit, duke kryer punime #shtrimi të rrugëve të brendshme me 100m3 (beton), në rrjetin rrugor të komunitetit, të cilat u ndoqën edhe nga kryetari i Bashkisë, Z. Kristo Kiço. Theksojmë se punimet realizohen në kuadër të #përmirësimit të infrastrukturës rrugore, me #burimet e Bashkisë, duke pasur efekte të dobishme në përditshmërinë e qytetarëve, diçka që #lexohet qartë në fytyrat e #të moshuarve tanë.”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/foinikaion/photos/pcb.3413354248937399/3413353232270834/>

Më datë 21.3.2023, bashkisë Finiq i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike. Bashkia Finiq nuk i është përgjigjur kërkesës tonë për bashkëpunim.

Të ndodhur në këto kushte, pasi shqyrtova të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se për të dhënat që disponohen, të nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar se veprimtaria e kryera nga subjekti i denoncuar nuk përbën veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Pjesëmarrja e punonjësve në punime, nuk e bën aktivitetin publik nga natyra, pasi kryetari i bashkisë në këtë rast është në përmbushje të detyrave të veta funksionale. Përsa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ për rastin objekt denoncimi.

13- Bashkia Kuçovë nuk ka raportuar 2 (dy) veprimtari publike, të regjistruara me nr. 271, 272 ID, për të cilat pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 271 ID *“Kafenë e mëngjesit e shijova bashkë me bisedat me dy grupe veteranësh. Do të shfrytëzoj çdo mundësi për t’u afruar akoma më shumë me secilin.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=665465858920640&set=pcb.665465908920635> .”

- Denoncimi nr. 272 ID *“Nga takimi i pasdites, ku mbështetja për të vazhduar punët jep përgjegjësi dhe shumë motivim!*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=665098678957358&set=pcb.665098862290673> ”

Theksohet se këto aktivitete nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.

Më datë 11.4.2023, bashkisë Kuçovë i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike. Në përgjigje të kërkesës sonë për bashkëpunim, bashkia Kuçovë nër tëjera bën me dije se: *“Këto takime janë zhvilluar në cilësinë e Kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kuçovës dhe jo në cilësinë e kryetarit të bashkisë.*

Nuk është përdorur ndonjë infrastrukture publike apo burimi tjetër publik.

Këto dy aktivitete nuk janë pasqyruar në rrjetet sociale të bashkisë Kuçovë, por në rrjetet e mia sociale personale/private.”

Përsa më sipër, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe faktet, të administruara gjatë hetimit administrativ, vlerësoj se referuar nenit 92, aktiviteti është organizuar nga subjekte që nuk kanë detyrimin për raportim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky detyrim i atribuohet institucioneve publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencive dhe/ose

ndërmarrjet shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik. Të ndodhur në këto kushte, duke marrë parasysh edhe tematikën e veprimtarisë, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj bashkisë Kuçovë.

14- Bashkia Himarë nuk ka raportuar 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me nr. 268 ID, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 268 ID *“Pilur, 4 Prill 2023. Takim mbresëlënës me njerëzit e mrekullueshëm të një prej fshatrave më të bukur të Rivierës Shqiptare.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=697265725735733&set=pcb.697266872402285>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 11.4.2023, bashkisë Himarë, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe më 13.4.2023 jemi informuar se *“...Nga ana e bashkisë Himarë më datë 4 Prill 2023, në fshtatin Pilur, nuk është organizuar asnjë veprimtari publike, për këtë arsye nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së.*

Pasi jemi njohur me e-mailit Tuaj, kemi kontaktuar me Kryetarin, i cili na ka sqaruar se publikimi në rrjetin social facebook, të cilit ju i referoheni, pasqyron një takim informal, rastësor të z. Jorgo Goro, në një nga lokalet e Pilurit përgjatë një kafeje në orët e mbasdites që ai kishte planifikuar me një mik të tij.

Në takim, përveç z. Jorgo Goro, nuk ka patur asnjë përfaqësues nga ana e Bashkisë Himarë, apo ndonjë përfaqësues funksionar të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Dega Himarë.”

Ashtu sikurse është e zakonshme për mjediset sociale të zonave rurale, në momentin që nga ana e klientëve/ qytetarëve që ishin në ambientin e lokalit u vu re prania e z. Jorgo Goro, në mënyrë të natyrshme u iniciua një bisedë e përbashkët miqësore e cila zgjati rreth 30 minuta. Në respekt të asaj atmosfere miqësore Z. Goro ka publikuar një postim në rrjetet sociale...”

Përsa më sipër, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe faktet, të administruara gjatë hetimit administrativ, vlerësoj se referuar nenit 92, të Kodit Zgjedhor aktiviteti është rastësor dhe nuk është organizuar nga subjekte që nuk kanë detyrimin për raportim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky detyrim i atribuohet institucioneve publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik. Të ndodhur në këto kushte, duke marrë parasysh edhe tematikën e veprimtarisë, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj bashkisë Himarë.

15- Bashkia Divjakë nuk ka raportuar 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me nr. 263 ID, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 263 ID *“Ndjekim nga afër punimet për #Rikonstruksionin e shëtitores të qytezës Çermë Sektorit, një shëtitore e cila do ti shërbej të gjitha moshave të këtij komuniteti. Falenderim për punonjësit e Shërbimeve Publike për punën intensive në këtë Njësi Administrative. #ShërbimePublikePrioritet #KërkesateBanorëvePrioritet”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=5918559914866561&set=pcb.5918560048199881>

Më datë 11.4.2023, bashkisë Divjakë, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 13.4.2023, jemi informuar se *“...ju sqaroj se, unë si person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publik nuk kam pasur informacion.*

Më tej, nga ana e kryetarit të bashkisë më është komunikuar që vizita e tij ku po kryhen punime për ndërtimin e trotuarit në fshatin Çermë Sektor, ishte thjeshtë monitorues për ecurinë e punimeve dhe është takuar vetëm me punonjësit e shërbimeve komunale... Gjatë vizitës rutinë që ka kryer në kantierin e ndërtimit, nuk ka takuar qytetarë, por vetëm ka dhënë udhëzimet dhe mbikëqyrur ecurinë e punimeve në këtë shëtitore. Po ashtu, kryetari i bashkisë sqaron që momentet nga vizita e tij në këtë shesh punimesh i ka postuar vetëm në rrjetin e tij personal social Facebook, dhe jo në faqet zyrtare të institucionit...”.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se pjesëmarrja e kryetarit të bashkisë në këtë aktivitet lidhet me detyrat funksionale të tij. Të ndodhur në kushtet që veprimtaria e mësipërme, për shkak të tematikës dhe natyrës së saj, nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, vlerësoj se duhet të mirëkuptohet situata e krijuar, të pushohet hetimi administrativ dhe t’i tërhiqet vëmendja të gjithë personave përgjegjës për raportim, të institucioneve të përfshira në këtë veprimtari, për përmbushjen e këtij detyrimi.

16- Bashkia Pukë, nuk ka raportuar 2 (dy) veprimtaritë publike, të regjistruara me nr. 277, 278 ID, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 277 ID *“Si çdo mbrëmje në njesitë administrative, sonte me supër skuadren e Qelzës#GjonGjonajPërPuken#VazhdojmëBashkëZhvillimineQelzës #PartiaSocialisteeShqiperisë”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=617402833754973&set=a.451806836981241.>”

- Denoncimi nr. 278 ID *“Forcohen kapacitetet për reagimin ndaj zjarreve në pyje, në bashkinë e Pukës. Kryebashkiaku Gjonaj i shoqëruar nga zv.kryetarja, Ershela Gjoni, drejtori Juridik, Endrit*

Kraja dhe shefi i Emergjencave Civile në bashki, Behar Ademi, i dorëzuan këtë mëngjes mjetin shefit të Shërbimit Zjarrfikës pranë bashkisë, Agron Hadroj. #PunaPërPukenQëDuam #PunëJoLlafe #BashkiaPukë #MbrojtjaCivile #AKMC #UCPM #MOD #EU"

Prova link:

<https://www.facebook.com/100064645183888/videos/873062470430301/>

Theksohet se këto aktivitete nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 11.4.2023, bashkisë Pukë, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 13.4.2023 jemi informuar se:

Mbi denoncimin **277 ID**, ju bejmë me dije se, *“aktiviteti është veprimtari politike/elektorale, që nuk raportohet në KQZ gjë e cila është publikuar në faqen zyrtare të facebook-ut të titullarit të institucionit dhe e organizuar pas orarit zyrtar të punës...”*.

Mbi denoncimin **278 ID**, ju bëjmë me dije se, *“veprimtaria nuk është parashikuar dot pasi sapo është sjellë mjeti është dorëzuar dhe hedhur në facebook për transparencë sepse kështu e ka kërkuar dhuruesi...”*.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas shqyrtimit të materialeve u vlerësua se natyra e aktivitetit të kryer në denoncimin **nr. 277 ID** nga kryetari i bashkisë Pukë është i karakterit politik dhe nuk është veprimtari publike e institucionit të bashkisë. Aktiviteti është zhvilluar në kuadër të veprimtarive politike me anëtarë dhe mbështetës të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Kryetari i bashkisë, si funksionar i partisë ku aderohet, mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete dhe të shprehë mendimet e veta. Këto veprimtari nuk kanë detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve pasi nuk janë zhvilluar në cilësinë si kryetarë bashkie. Përsa më sipër, rezultoi se veprimtaritë objekt denoncimi për bashkinë Pukë nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenet 91, dhe 92 të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar denoncimit **nr. 278 ID** në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi për shkak të tematikës dhe natyrës, aktivitetet e mësipërme nuk futen në kategorinë e veprimtarive të cilat kanë detyrimin për raportim në kuptim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ sepse objekti rast denoncimi nuk përmban rrethana, që mund të përfshihen në parashikimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për:
 - a. Zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lushnje;
 - b. Zj. Arisa Toska, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Berat;
 - c. Z. Nertil Nebiaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastrë;
 - d. Z. Dritan Babasuli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Pogradec;
 - e. Z. Elvis Gjika person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kamëz;
 - f. Z. Taulant Fejzulla, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Vorë;
 - g. Z. Florenc Doka person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Cërrik;
 - h. Z. Genci Floqi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Maliq;
 - i. Zj. Urjeta Kurti, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Dibër;
 - j. Z. Oltjon Çoba, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë, Bashkia Fushë Arrëz;
 - k. Z. Astrit Seferkolli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll;
 - l. Z. Vangjel Xhaferi person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Finiq;
 - m. Zj. Marsida Fani person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kuçovë;
 - n. Zj. Rajmonda Zisi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Himarë;
 - o. Zj. Klevisa Rrudha, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Divjakë;

- p. Zj. Emirjona Pergjegjaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Pukë;
- q. Zj. Vikrita Cuto, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Ministrit të Infstrukturës dhe Energjisë.
2. Tërheqje vëmendje për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
 3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI